

Njoftim për shtyp, datë 28 Korrik 2021

28 July, 2021 by **KLGI** in **NJOFTIME PËR SHTYP**

Sot, në datën 28.07.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi mbledhjen plenare të radhës, në të cilën shqyrtoi çështjet si vijon:

Në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.287, datë 06.07.2020, për kandidaten znj.Elsa Ulliri.

Gjithashtu, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.290, datë 06.07.2021, për kandidatët, znj.Arben Ahmeti, znj.Enerjeta Shehaj (Deraj), z.Engert Pëllumbi, znj.Rezarta Aliu (Paja) dhe z.Sokol Ibi.

Informacioni i mësipërm është marrë në faqen zyrtare të KLGJ-së, në rubrikën e njoftimeve, në linkun: <https://klgj.al/2021/07/njoftim-per-shtyp-date-28-korrik-2021/>